

Trustworthy Computing



Të rinjtë dhe interneti

Ndihmojmë mbrojtjen e Fëmijëve në Botën në linjë

Tetor 2009

The information contained in this document represents the current view of Microsoft Corp. on the issues discussed as of the date of publication. Because Microsoft must respond to changing market conditions, it should not be interpreted to be a commitment on the part of Microsoft, and Microsoft cannot guarantee the accuracy of any information provided after the date of this presentation.

This white paper is for informational purposes only. MICROSOFT MAKES NO WARRANTIES, EXPRESS OR IMPLIED, IN THIS DOCUMENT.

Complying with all applicable copyright laws is the responsibility of the user. Without limiting the rights under copyright, no part of this document may be reproduced, stored in or introduced into a retrieval system, or transmitted in any form or by any means (electronic, mechanical, photocopying, recording or otherwise), or for any purpose, without the express written permission of Microsoft.

Microsoft may have patents, patent applications, trademarks, copyrights or other intellectual property rights covering subject matter in this document. Except as expressly provided in any written license agreement from Microsoft, the furnishing of this document does not give you any license to these patents, trademarks, copyrights or other intellectual property.

© 2009 Microsoft Corp. All rights reserved.

Microsoft, Internet Explorer, Mediaroom, Windows, Windows Live, Windows Vista, Xbox 360, Xbox LIVE and Zune are either registered trademarks or trademarks of Microsoft Corp. in the United States and/or other countries. The names of actual companies and products mentioned herein may be the trademarks of their respective owners.

Microsoft Corp. • One Microsoft Way • Redmond, WA 98052-6399 • USA

Përmbyta

Hyrje

Për fëmijët, Interneti është njëkohësisht një klasë dhe kënd loje virtual – vend ku mund të mësojnë, lidhen me miq dhe kënaqen. Por kur fëmijët hulumtojnë dhe hyjnë në interaksion në linjë, mund të hasin në përmbajtje që prindërit nuk do të dëshironin që ata ti shohin, apo të kontaktojnë me njerëz që për ta paraqesin kërcënim. Rreziqe tjera **potenciale nisur nga shkarkimi i paqëllimtë apo softuer dashakeq e deri tek ngacmime në linjë, njohur ndryshe si "sajbercytje"**. Pothuajse një e treta e adoleshentëve evropian kanë qenë të cytur në Internet, sipas një studimi pak kohë më parë të sponsoruar nga Microsoft, ndërsa një studim amerikan zbuloi se më tepër se një nga pesë nxënës të shkollave të mesme ose kanë qenë viktimë e sajbercytjes ose kanë qenë cytës vetë ata.¹

Ndaj kuptohet që shumë prindër dhe edukatorë janë të brengosur për kërcënimet ndaj sigurisë dhe fshehtësisë së fëmijëve në linjë. Kjo brengë zmadhohet me vetë faktin se fëmijët jo gjithmonë kuptojnë rreziqet që ekzistojnë në linjë apo përdorin kufinj të vetanake të mirësjelljes së zakonshme dhe rregullave shoqërore që ekzistojnë në botën fizike edhe në përvojat e tyre në linjë. Megjithatë, e vërteta është se shumë fëmijë dhe adoleshentë sot rriten të zhytur në një botë digjitale, të ndërlidhur; dhe për shumë, Interneti është një pjesë jetike e jetës së tyre. Në SHBA, 71 përqind e adoleshentëve me qasje në linjë kanë një profil të tyrin në rrjetet për shoqërim.² Gjysma e fëmijëve britanikë të moshës 12 deri në 18 vjeç përdorin mesazhet e çastit.³ Në mesin e fëmijëve australianë që përdorin internetin, 75 përqind vizitojnë faqe interneti që ndajnë video dhe 95 përqind luajnë lojë në linjë.⁴ Në Brazil, 89 përqind e fëmijëve që kanë qasje në linjë shkarkojnë muzikë.⁵

Prindërit dhe kujdestarët janë në pozitën më të qëlluar për të sjellur vendime për atë se ç'është e përshtatshme për fëmijët dhe për të folur me ta për sigurinë në linjë. Për t'i ndihmuar ata në këtë rol të rëndësishëm, Microsoft ka investuar konsiderueshëm në krijimin e tipareve të sigurisë familjare në linjë dhe integritetit të tyre në një paletë të gjërë të prodhimeve dhe shërbimeve për konsumatorë. Gjithashtu bëjmë përpjekje të mëdha – shpesh në bashkëpunim me ekspertë për zhvillimin e fëmijëve dhe organizata jo fitimprurëse – për të dhënë materiale udhëzuese dhe arsimore për mësuesit, prindërit dhe fëmijët. Për më tepër, punojmë me partnerë të fuqizimit të ligjit, nga industria dhe qeveri për të ndihmuar luftën e kimit të internetit dhe për të përforcuar legjislativonin që mbron fëmijët nga ekspluatimi në linjë.

Përkushtimi i Microsoft për Përmirësim të Sigurisë në Linjë të Fëmijëve

Ta bëjmë internetin më të sigurtë për fëmijët bashkërendit me përkushtimin e kahmotshëm të Microsoft për të ritur besimin dhe sigurinë në linjë dhe për të mbrojtur sigurinë dhe fshehtësinë e konsumatorëve. Përpjekjet tona për të promovuar sigurinë familjare në botën digjitale shtrihen në këto tre fusha kyçe:

- **Veglat dhe teknologjia.** Ne fusim rregullimet e sigurisë familjare dhe kontrollit prindëror në Microsoft® Windows® 7, Windows Vista®, Windows Live™, Xbox 360®, Xbox LIVE®, Zune® dhe prodhime dhe shërbime tjera.
- **Udhëzim dhe arsimim.** Microsoft punon me qeveri, organizata jo fitimprurëse dhe shoqërore për të ndihmuar prindërit dhe fëmijët që të kuptojnë më mirë rreziqet në linjë dhe si t'i zvogëlojnë ato. Këto përpjekje përfshijnë një paletë nga faqet informative të internetit dhe plane mësimore për sigurinë në

internet e deri tek fushata publike informative, përfshirë dhe ngjarjet për vetëdijësim "Internet më i sigurtë" që mbahen në tërë rruzullin tokësor.

- **Fuqizimi i ligjit dhe politika publike.** Microsoft punon me agjenci për fuqizim të ligjit dhe partnerë

Siguria dhe Fshehtësia në Microsoft

Prioritetet kryesore për Microsoftin janë mbrojtja e sigurisë dhe sigurimit të konsumatorëve. Në 2002-ën, nisëm një iniciativë të përdorimit të Besueshëm të Kompjuterëve, një përkushtim i tërë kompanisë për dhënie të përvojave të punës me kompjuter për të gjithë në mënyrë të sigurtë, private dhe të besueshme. Përpos përfundimit të praktikave tona të zhvillimit të softuerit, përdorimi i Besueshëm i Kompjuterëve përfshin dhe udhëzimet për konsumatorët lidhur me praktikën më të mirë të sigurisë dhe fshetësisë dhe përkrahje për legjislacionin që ka për vokacion të bëjë përndjekjen kriminale të sjelljes në linjë. Gjithashtu, Ekipi i Microsoftit për Fuqizimin e Sigurisë së Internetit punon me agjencitë për fuqizim të ligjit në tërë botën për të siguruar trajnim dhe përkrahje për hetimet, koordinimet dhe përndjekjen.

Politikat e korporatës sonë –duke përfshirë një sërë parimesh për fshehtësi që u lëshuan në vitin 2007 që kanë të bëjnë me kërkimin dhe reklamën në linjë - pasqyrojnë qëndrimin tonë të kahmotshëm se konsumatorët duhet të kenë aftësi të kontrollojnë mbledhjen, përdorimin dhe shpalljen e informatave të tyre personale. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur është fjala për përdorimin e internetit nga të rinjtë. (Detaje për politikën e fshehtësisë të Microsoft mund të gjenden në <http://privacy.microsoft.com/>.)

tjerë për të ofruar vegla dhe trajnim që ndihmojnë kapjen dhe përndjekjen e kriminelëve që kërkojnë të lëndojnë fëmijët që i kontaktojnë duke përdorur internetin. Gjithashtu përkrahim përpjekjet e qeverisë për të përpiluar dhe vënë në fuqi politika publike që ndihmojnë mbrojtjen e përdoruesëve ligjorë të internetit dhe për të dënuar kriminelët në linjë.

Teknologji


Kur është fjala për ndihmë në mbrojtjen e fëmijut në linjë, nuk ka teknologji që mund të zëvendësojë mbikqyrjen dhe udhëzimin prindëror. Microsoft është i përkushtuar të sigurojë softuer dhe vegla tjera që mund të ndihmojnë prindët në këtë detyrë të rëndësishme. Një paletë e gjërë e prodhimeve dhe shërbimeve Microsoft ofrojnë rregullime të sigurisë familjare, përfshi dhe Windows Vista, Windows Live, Xbox 360, Xbox LIVE, Zune dhe Mediaroom™. Këto përfshijnë **teknologji që u japin prindërve kontroll më të madh të asaj në të cilën fëmijët qasen dhe si mund të ndërliken përmes internetit dhe në hapësira tjera në linjë.**

Windows kontrolli prindëror

Kontrolli prindëror, që është i futur në të gjitha edicionet shtëpiake (Home) të sistemit operativ


Windows Vista dhe të gjitha edicionet e Windows 7, mundëson krijim të llogarive të veçanta për çdo anëtar të familjes.

Duke përdorur kuadrin Windows kontrolli prindëror, prindërit mund të përcaktojnë se kur, dhe për sa kohë, fëmijët e tyre mund të përdorin kompjuterin; dhe cilat aplikacione softuerike mund t'i përdorin. Prindërit gjithashtu mund të kufizojnë qasjen në softuerin e lojërave kompjuterike në bazë të titullit, përmbajtjes apo vlerësimit. Ata mund të kenë raport të detajuar të përdorimit të kompjuterit nga ana e fëmijut për t'i ndihmuar të sigurohen se fëmiju i tyre viziton vetëm internet faqe që janë në pajtim me vlerat familjare.



lejojnë veçanërisht vetëm disa faqe interneti. Një rregullim tjetër u mundëson prindërve të parandalojnë fëmijët të shkarkojnë softuer.

Për të kufizuar sasinë e kohës që fëmiju kalon në përdorimin e kompjuterit, prindërit mund të përdorin një tabelë të thjeshtë përzgjidh dhe kliko për të caktuar ditët e "bllokuara" dhe ditët e "lejuara" të javës si dhe orarin e përdorimit gjatë këtyre ditëve. Me të arritur fundi i një kohe të lejuar, fëmiju pranon një lajmërim se i kanë ngelur 15 minuta e më pas 1 minutë kohë. Nëse koha e caktuar përfundon para se fëmiju të jetë



Monitorimi i kompjuterit të fëmijëve ndihmon prindërit të rafinojnë dhe modifikojnë kufizimet në bazë të veprimeve dhe ofron bazë aktuale për diskutim të informuar me fëmijët e tyre për përdorimin e internetit dhe vetitë e punës në linjë. Ikona e kontrollit prindëror në kutinë sistimore të Windows është gjithmonë e dukshme që fëmijët ta dijnë se ky tipar është i aktivizuar.

Për filtrim të përmbajtjes së internetit, prindërit mund të krijojnë rregullime të personalizuar që bllokojnë faqet sipas llojit të përmbajtjes (siç janë përmbajtjet për të rritur, pornografi apo edukatë seksuale) apo të

çlajmëruar, Windows Vista pezullon sesionin dhe e ruan tërë punën e fëmiju.

Nga kuadri i Kontrollit Prindëror, përdoruesi gjithashtu mund të aftësojë tipare sigurie si ato të filtrimit të përmbajtjes që janë të futura në softuere dhe shërbime të palëve të treta. Për të shmangur konfliktet në raste të tilla, softueri i palës së tretë mer vendin e Kontrollit Prindëror në menaxhimin e rregullimeve të sigurisë familjare. Microsoft gjithashtu ofron interfejs për programim të aplikacioneve (IPA) që ndihmon zhvilluesit të ndërtojnë mbi platformën e Windowsit.

Qendra Windows Media


Tipari Qendra Windows Media në edicionet Windows Vista Home Premium dhe Ultimate u mundëson përdoruesëve të shikojnë dhe incizojnë televizion drejtëpërdrejtë në kompjuterët e tyre. Ata kanë brenda vetes Kontrollin Prindëror që u mundëson prindërve të kufizojnë pamjen e zbavitjes digjitale në bazë të vlerësimeve

të industrisë (përfshirë dhe vlerësimet nga Shoqata Amerikane e Filmave të Luajtur). Me këtë Kontroll Prindëror, prindërit mund të:

- Caktojnë maksimumin e lejuar të vlerësimeve për televizion dhe përmbajtje filmike (si psh PG-13 apo TV-14)
- Kufizojnë qasjen tek programet pa vlerësim
- Blllokojnë qasjen në program në bazë të kategorisë: dhunë fantastike, dialog sugjektiv, e folur ofenduese, përmbajtje seksuale apo dhunë

Windows Live

Windows Live (<http://download.live.com>) është një seri shërbimesh interneti dhe aplikacionesh kompjuterike që ndihmojnë njerëzit që të jenë më mirë të lidhur dhe të marrin maksimumin nga përvoja e tyre Windows. Këto përfshijnë dhe e-postë klientin të Windows Live Hotmail®, rrjetet për shoqërim me Windows Live Spaces, mesazhe të çastit me Windows Live Messenger dhe shërbime tjera.



Siguria familjare Windows Live integron pa asnjë të metë opcionin e sigurisë familjare për Windows Live shërbimet. Siguria familjare ofron filtrim të rregullueshëm të përmbajtjes së internetit, raporte për veprimet e secilit anëtar në familje, dhe tipare të menaxhimit të kontakteve për të ndihmuar parandalimin e ndërlidhjes së

fëmiut në Windows Live me individë që nuk janë aprovuar paraprakisht nga prindi. Prindët mund të monitorojnë aktivitetin në linjë dhe të freskojnë rregullimet nga cilido kompjuter i lidhur me internet.

Siguria Familjare Windows Live mund të përdoret dhe me Windows XP SP2 dhe versionet pas tij të sistemit operativ Windows. Ka optimizime të ekzekutimit për Windows Internet Explorer® 6 dhe versionet pas tij, por edhe shfletues tjerë gjithashtu janë të mbështetur.

Elementet kyçe të shërbimit përfshijnë:

- **Menaxhimi i kontakteve.** Kontaktet në linjë me të panjohur janë një brengë e rëndësishme për prindët për shkak të potencialit për ngacim, ndërlihdje të papërshtatshme në linjë dhe kontakt me vjedhës identiteti dhe grabitqarë tjerë. Prindët mund të përcaktojnë se cilët individë janë të lejuar të komunikojnë me fëmijët e tyre duke përdorur shërbimet Windows Live siç është Windows Live Hotmail dhe Mesenxher, dhe cilët persona kanë leje të shohin faqen në rrjetin për shoqërim të fëmiut apo bllogun në Windows Live Spaces. Rregullimet për menaxhim të kontakteve aplikohen edhe kur fëmiu lidhet në Windows Live nga kompjuteri jashta shtëpisë.
- **Filtrimi i përmbajtjes.** Prindërit mund të caktojnë rregullime të veçanta filtrimi për çdo anëtar familje. Këto rregullime lejojnë ose bllokojnë faqet e internetit në bazë të kategorive së përmbajtjes dhe aplikohen për të gjitha pamjet e përmbajtjes së internetit. Bazuar në 'informatat kthyesë' nga prindërit, versioni i fundit i Sigurisë Familjare të Windows Live ofron opsione filtrimi më të thjeshta të bazuara në kategoritë për përmbajtje për të rritur, edukatë seksuale, përmbajtje miqësore për fëmijë, rrjete për shoqërim dhe faqe për e-postë. Rezultatet nga kërkimi me Bing apo maqina kërkimi tjera populare filtrohen për fotografi dhe tekst me hollësi seksuale. Prindërit që duan opsione më të veçanta dhe një zgjedhje më të madhe të kategorive mund të shkarkojnë filtra shtesë nga partnerët e Microsoftit.
- **Paraqitja e keqpërdorimit.** Përdoruesit mund të paraqesin sjellje apo përmbajtje të papërshtatshme përmes rrjetit Windows Live të shërbimeve të internetit. Për shembull, një tast "Paraqit keqpërdorim" paraqitet në qoshin e poshtëm të çdo Windows Live hapësire (space).

Shërbimet tjera kryesore Windows Live ofrojnë vegla të veçanta për mbrojtje dhe fshehtësi:

Kërkimi me Bing

- Filtrim i rezultateve të kërkimit për tekste dhe fotografi me hollësi seksuale

Windows Live Messenger

- Manualisht krijoni listë të kontakteve të lejuara për mesazhe çasti
- Merni lajmërim sa herë që dikush provon t'u shtojë në listën e tij të Kontakteve të Mesenxherit
- Blloko një person që të mos të kontaktojë apo sheh nëse je në linjë

Windows Live Hotmail

- Cakto filtra personale të llogarisë ashtu që Windows Live Hotmail do t'u sjell postë vetëm nga njerëzit në listën tuaj të Kontakteve dhe dërgues tjerë të besueshëm
- Blloko të gjitha e-postat nga një adresë e-poste e caktuar

- Identifiko, në bazë të alarmeve të koduara me ngjyra, nëse një mesazh që vjen mund të jetë dashakeq apo i pandershëm

Windows Live Spaces

- Cakto Hapësirën Windows Live që të jetë plotësisht private, e qasshme vetëm për njerëzit e përzgjedhur, apo publike
- Qasu në informata për sigurinë nga cilado faqe e Hapësirës

Xbox 360 dhe Xbox LIVE

Xbox 360 dhe Xbox LIVE-përkatësisht platformat e Microsoft për lojëra dhe aheng dhe shërbimi i lojërave në linjë, – janë disejnuar për të siguruar mjedis më të sigurtë dhe më të përshtatshëm për moshën e të gjithë përdoruesëve. Tiparet e rregullimeve Familjare në konsolën Xbox 360 u mundësojnë prindërve në mënyrë të lehtë të caktojnë kufizimet që aplikohen si për lojën jashta ashtu për atë në linjë.

Konsola njih sistemet vlerësuese të lojës dhe videos nga shtete të tërë botës, duke u mundësuar prindërve të caktojnë kategoritë e lojërave, filmave dhe programeve televizive në të cilat fëmijët e tyre mund të kenë qasje.⁶ Gjithashtu ka tiparin Kohëmatës Familjar që prindërit mund të përdorin për të kufizuar kohëzgjatjen e përdorimit të konsolës në ditë apo në javë.

Për Xbox LIVE, konsola mund të konfigurohet për të lejuar lojëra në linjë dhe komunikim vetëm me miq të aprovuar dhe të kërkojë mbikqyrje prindërore për miq të ri. Gjithashtu lejon përdoruesëve të paraqesin përdorim të papërshtatshëm të shërbimit.



Më saktësisht, Rregullimet Familjare Xbox 360 u mundësojnë prindërve të:

- Caktojnë sipas dëshirës secilit fëmi hapësirën e lojës dhe pamjes
- Caktojnë se sa kohë mund një fëmijë të kalojë duke luajtur loja për çdo ditë ose çdo javë

- Caktojnë se cilat loja mund t'i luajë fëmiju, në bazë të vlerësimeve të lojës
- Caktojnë nëse fëmijut i lejohet të shkarkojë përmbajtje
- Caktojnë se cilat filma ose programe televizive mund t'i shikojë fëmiju, në bazë të vlerësimeve
- Krijojnë rregullime personale Xbox LIVE për llogarinë e një fëmiju që do të zbatohet nga cilado makinë e përdorur për t'u qasur në këtë llogari
- Kërkojnë pëlqim prindëror për listën e miqëve në linjë të fëmijut
- Caktojnë se çfarë tipi të komunikimit në linjë lejohet (dmth, tekst dhe audio, video)
- Kufizohet eksponimi në përmbajtje të pa vlerësuar nga ana e anëtarëve tjerë të bashkësisë Xbox Live
- Kufizojnë ndarjen e informatave nga profili personal vetëm me miqtë, ose të bllokujë fare ndarjen e informatave nga profili personal

Dhoma e mediave

Microsoft Dhoma e Mediave, versioni i fundit i platformës së Microsoft Protokolit për Internet Televizion (MPIT), u mundëson operatorëve kablovik dhe kompanive të telekomunikacionit të ofrojnë përmbajtje dhe shërbime si kanalet televizive me definicion të lartë, video incizime digjitale dhe video sipas kërkesës.

Dhoma e Mediave përfshin tipare të kontrollit prindëror për menaxhimin e qasjes së fëmijut në kanale, shfaqje dhe shërbime. Me përdorim të fjalëkalimeve, prindërit mund të kufizojnë:

- Qasjen në programe sipas vlerësimit (me vegla specifike për bllokim të programit të vlerësuar si për të rritur)
- Qasjen në programet pa vlerësim
- Qasjen në kanalet individuale
- Aftësinë për të blerë video dhe përmbajtje tjera sipas kërkesës

Zune

Prindërit mund të përdorin Rregullimet Familjare për të kufizuar qasjen e fëmijëve të tyre në përmbajtjen e shitores muzikore në Tregun në linjë Zune për përdorim në media lexuesin e tyre portativ Zune. Veçanërisht, prindërit mund të:

- **Caktojnë** nëse fëmiju mund të bëjë blerje nga Tregu Zune
- **Kufizojnë qasjen e fëmijut** në përmbajtje eksplicite, përfshirë dhe lirikën e muzikës, që është në dispozicion në Tregun Zune
- Kufizojnë qasjen e fëmijut në filma të vlerësuar mbi PG apo TV programet të vlerësuar mbi TV-PG
- **Caktojnë** kush mund ti dërgojë mesazhe fëmijut në bashkësinë shoqërore në linjë Zune (fëmijëve deri në 12 vjet u është ndaluar bashkangjitja në bashkësi)
- **Caktojnë** nëse fëmiju mund të pranojë kërkesat e miqve në bashkësinë shoqërore në linjë Zune
- **Caktojnë** nëse fëmiju mund të ndajë artistët dhe këngët e preferuar me bashkësinë Zune

- **Caktojë** se kush mund të sheh listën e miqëve të fëmijut

Udhëzim dhe Arsimim i Konsumatorëve

Përderisa veglat dhe teknologjitë mund të ndihmojnë promovimin e sigurisë së fëmijëve në internet, prap se prap edukimi i prindërve dhe fëmijëve mbetet akoma elementi më i rëndësishëm i ndihmës për tu përgjigjur në rreziqet në linjë. Burimet edukative që janë në dispozicion të familjeve përfshijnë një paletë nga faqet informative të internetit dhe plane mësimore për sigurinë në internet e deri tek fushata publike informative, përfshirë dhe ngjarjet për vetëdijësim "Internet më i sigurtë" që mbahen në tërë rruzullin tokësor. Microsoft përkrah organizata të shumta për edukimin e familjeve për sigurinë dhe programe gjithpërfshirëse, përfshirë:

- **Ad Koalicionin për Siguri të Internetit të Këshillit (KSI).** Microsoft është anëtar i KSI, një organizatë amerikane që punon për të ndihmuar fëmijët që të kuptojnë më mirë se interneti është hapësirë publike dhe të spjegojë rrezikun e postimeve në internet që llogariten si të këqija.
- **Patrolla e Tipave të Këqij** Një pjesë e përkushtimit të përbashkët të Microsoft Kanada dhe Shërbimeve për Fëmijë të Qeverisë së Albertës për të ulur ekspluatimin seksual të fëmijëve, www.badquy patrol.ca përdor lojëra që ua mësojnë fëmijëve të moshës 5 deri në 10 vjeçare aftësitë kritike për siguri në internet. Një seksion për të rritur ofron informata shtesë për atë se si të ndihmohet mbajtja e fëmijëve të sigurtë. Programi gjithashtu ofrohet dhe në krahina tjera kanadeze.
- **Resurset në linjë për sigurinë e lojërave** Në Francë, Microsofti punon me partnerë që shtrihen në industrinë e lojërave, qeverinë, shoqata të lojtarëve, organizata familjare dhe avokatë të mbrojtjes së fëmijëve për të përkrahur një faqe të re edukative interneti, PedaGoJeux (<http://www.pedagojeux.fr>), që ofron burime për lojë të sigurtë për prindërit dhe promovon sistemin e vlerësimit PEGI.
- Fushata "Bën Lojë të Zgjuar" Në internet faqen e re të Microsoft, Bën Lojë të Zgjuar (www.GetGameSmart.com), familjet mund të gjejnë informata për vlerësimet e lojërave, kontrollin prindëror, strategji për menaxhimin e kohës në ekran, informata për sigurinë në linjë dhe këshilla nga ekspertë për përdorimin e mediave. Vizitorët gjithashtu mund të marrin pjesë në aktivitete interaktive të siguruara familjare dhe të ndajnë informata për lojë më të sigurtë.
- **BënRrjetZgjuarësi.** Microsoft përkrah këtë organizatë publike edukative dhe internet faqen (www.getnetwise.org), që ofron informata për përdorim më të sigurtë të internetit.
- **Bëhu më i Sigurtë në Linjë.** Microsoft është promotor themelues, bashkë me qeverinë e Britanisë së Madhe dhe kompani tjera udhëheqëse, i kësaj fushate dhe faqe interneti (www.getsafeonline.org), që i përkushtohet mësimin të konsumatorëve dhe bizneseve lidhur me sigurinë dhe sigurimin e internetit.
- **Forumi Këshillues për Sigurinë e Informatave.** Microsoft India ka punuar bashkë me disa organizata publike dhe private për të krijuar këtë forum (www.getnetsecure.in) për komunikim të njëzuesur lidhur me çështjet e sigurisë së informatave. Microsoft India ka bërë gjithashtu në partneritet me CERT nismën e www.secureyourpc.in, një faqe interneti të fokusuar kah konsumatorët për sigurinë kompjuterike dhe sigurimin.
- **Lidhja Kombëtare për Sajber Siguri (LKSS).** Microsoft është kompani anëtare e Bordit të Drejtorëve të këtij partneriteti amerikan jo fitimprurëse publiko-privat, që ofron siguri interneti dhe

informata sigurimi në linjë dhe përmes përpjekjeve për arsim siç është Muaji i Vetëdijimit për Sajber Sigurinë Kombëtare.

- **RrjetSiguri.**RrjetSiguri dhe Microsoft Zelanda e Re zhvilluan faqen e sigurisë në linjë Bota e Hektorit (www.hectorsworld.org.nz), që ofron plan mësimor për sigurinë e internetit për mësues si dhe një paletë të aktiviteteve argëtuese për fëmijë që i mësojnë ata për përdorim më të sigurtë të internetit.
- **NëRoje në Linjë.** Microsoft ndihmoi zhvillimin e faqes së internetit të Komisionit Federal Amerikan për Tregti në www.onguardonline.gov, që ofron informata praktike për konsumatorët, artikuj, video dhe aktivitete interaktive që kanë të bëjnë me sigurinë në linjë dhe sigurimin.
- **Internet Ngjarje më të Sigurta** Microsoft ndihmon përkrahjen e fushatave për siguri të internetit në shtete të botës, përfshirë dhe fushatën Dita e Bashkimit Evropian për Internet më të Sigurtë, Dita e Sigurisë Kombëtare në Japoni dhe fushata Navega Protegido në tërë Amerikën latine.
- **Qëndro i Zgjuar në Linjë.** Si pjesë e kësaj iniciative të qeverisë australiane (www.staysmartonline.gov.au), Microsoft ndihmoi organizimin dhe promovimin e Javëve të Vetëdijimit Kombëtar për E-Siguri në 2006-ën dhe 2008-ën. Microsoft gjithashtu shërben në saje të Komitetit Konsultativ Qeveritar për Sajber Siguri dhe punon me Policinë federale australiane dhe Autoritetin australian për Komunikim dhe Media në **ThinkUKnow** (www.thinkuknow.org.au), një përpjekje për promovim të sigurisë në linjë në mesin e prindërve, mësuesëve dhe fëmijëve.
- **Siguri në lidhje.** Microsoft përkrah Konferencën e parë ndërkombëtare për Siguri në lidhje për sajbercytje në 2008-ën, me ç'rast u mbledhën përfaqësues nga qeveria, arsimi, media, industria teknologjike dhe të tjerë për të ngritur vetëdijësimin për këtë çështje të rëndësishme.

Përpos këtyre partneriteteve, faqja jonë www.microsoft.com/protect/family ofron informata të gjëra dhe udhëzime për sigurinë në linjë dhe fshehtësinë personale.

Fuqizimi i Ligjit dhe Politika Publike

Microsofti punon me qeveritë në përforcimin e ligjeve për siguri në linjë dhe fshehtësi, dhe në inkurajimin e zhvillimit dhe zbatimit të programeve obliguese në shkolla për sigurinë në internet. Këto përpjekje, që i kushtohen përdorimit të internetit nga fëmijët, si dhe çështjeve më të gjëra kriminale si pornografi fëmijërore në linjë, përfshijnë:

- **Punën me zyrtarë të fuqizimit të ligjit në tërë botën për të vendosur Sisteme të Përcjelljes së Ekspluatimit të Fëmijëve (SPEF), një vegël softuerike unike që u mundëson hetuesëve të ndajnë dhe analizojnë informata për përcjelljen e ekspluatimit të fëmijëve në internet. Fillimisht i nxitur nga një e-postë nga zyrtari kanadez për fuqizim të ligjit dërguar kryetarit të Microsoft Bill Gejts, SPEF përdoret apo zhvillohet në pesë shtete nga qindra zyrtarë të fuqizimit të ligjit, ndërsa është në diskutim e sipër edhe zhvillimi i disa SPEF shtesë.**
- **Partneritetin me INTERPOL-in dhe Qendrën Ndërkombëtare për Fëmijë të Zhdukur dhe Ekspluatuar (QNFZHE) për dhënie të trajnimit botëror për personelin e fuqizimit të ligjit që hetojnë krime kundër fëmijëve të lehtësuara përmes kompjuterit. Më se 3200 zyrtarë për**

fuqizimin e ligjit nga më se 110 shtete janë trajnuar në metodat e identifikimit të të dyshuarëve, hetimit të kundërvajtjeve dhe ndihmës së viktimave të grabitqarëve të fëmijëve në linjë.

- Kontribut për **Dërgatën Teknike për Siguri në Internet**, një koalicion akademikësh, i industrisë, grupeve për mbrojtje dhe të tjerëve që ekzaminojnë çështjet e lidhura me sigurinë e internetit, vërtetimit në linjë dhe verifikimit të moshës së fëmiut.

Lufta kundër trafikut të fotografive të keqpërdorimit të fëmijëve në internet është pjesë e rëndësishme e të gjitha përpjekjeve tona. Për këtë qëllim, rekuizitat tona në linjë përdorin mekanizma të fuqishëm, lehtë të identifikueshëm për paraqitje të keqpërdorimit, përpos filtrit që ndihmon detektimin e fotografive të keqpërdorimit të fëmijëve. Përgjigjemi shpejtë në paraqitjet e të gjitha keqpërdorimeve në linjë në të gjitha faqet tona, përfshirë dhe paraqitjet e pornografisë fëmijërore, ngacmimit, hakimit të llogarive, spamit, lakuriqësisë së të rriturëve dhe tjera. Në pajtim me politikat e kompanisë për siguri në linjë, paraqesim të gjitha fotografitë me pornografi fëmijërore të qartë në Qendrën Kombëtare për Fëmijë të Zhdukur dhe Ekspluatuar (QKFZHE), heqim fotografinë dhe e dëbojmë përdoruesin nga shërbimet tona. Gjithashtu drejtojmë një qendër ankesash ku përdoruesit e tërë botës mund të paraqesin incidente të keqpërdorimit të faqeve tona. Microsoft proceson dhe u përgjigjet këtyre ankesave sakaq. Për më tepër, punojmë me Koalicionin Teknologjik të QKFZHE për të zhvilluar vegla teknologjike që ndihmojnë dhënësit e shërbimeve elektronike që më lehtë të identifikojnë dhe tërheqin fotografitë e keqpërdorimit të fëmijëve apo adresat e internet faqeve dhe të njëjtat ti paraqesin pranë QKFZHE.

Microsoft ka punuar me udhëheqës qeveritar në dhjetëra shtete amerikane për të bërë trajnime gjithëpërfshirëse për forcat e rendit dhe ligjit lidhur me krimet e lehtësuara nga kompjuteri. Në prill të 2008-ës, ishim promotor i Forcat e rendit dhe ligjit Tek, një seri e seancave trajnuese intenzive tre ditore që bashkuan 400 togerë të forcave të rendit dhe ligjit nga 35 shtete për të mësuar se si hulumtohen krimet e mundësuar nga teknologjia me përdorimin e veglave dhe teknologjive më të reja.

Në prill të 2006, iu bashkangjitëm QKFZHE në shpalljen e legjislacionit model për pornografi fëmijërore. Ky legjislacion ka për qëllim modernizimin e ligjeve mbi pornografinë fëmijërore për 184 shtetet anëtare të Interpolit. Microsoft është përbetuar të përkrahë përpjekjet për zhvillimin dhe fuqizimin e këtyre ligjeve në tërë botën.

Microsoft u është bashkangjitur partnerëve nga industria për të inkurajuar shtetet të adoptojnë dhe ratifikojnë ligjet konsistente me Konventën për Sajberkrime të Këshillit të Evropës, që kërkon nga nënshkruesit të adoptojnë dhe azhurnojnë ligjet dhe procedurat për tu përgjigjur krimeve në mjedisin në linjë. Gjithashtu kemi punuar afër me Këshillin Evropian dhe palë të treta, si Iniciative e Rrjetit Global, për të definuar procedurat e sigurimit të të dhënave për forcat e rendit dhe ligjit për ndihmë në hetime të krimeve – përfshirë krimet kundër fëmijëve – dhe njëkohësisht të respektohen të drejtat themelore siç është ajo e fshehtësisë dhe lirisë së shprehjes. Këto përpjekje përfshijnë dhe udhëzimet e Këshillit të Evropës për bashkëpunim të ofruesëve të shërbimeve të fuqizimit të ligjit, që mund ta merni në

www.coe.int/t/DGHL/cooperation/economiccrime/cybercrime/default_en.asp.

Roli i Udhëheqësve Qeveritar

Qeveritë mund të sigurojnë përkrahje të paçmueshme për industrinë dhe organizatat jo fitimprurëse që punojnë për të përmirësuar sigurinë në linjë. Përpos aprovimit të ligjeve më të fuqishme dhe rritjes së burimeve për të ndihmuar parandalimin e kriminelëve që përdorin internetin për të cenuar fëmijët dhe të tjerët, udhëheqësit qeveritar janë në pozicion unik për të përqëndruar kujdes më të madh për shndërrimin e sigurisë në linjë të fëmijëve në detyrim shoqëror.

Rekomandimet tona për vendimarrësit qeveritarë përfshijnë:

- **Kërkimin e edukimit të obligueshëm për siguri në internet si pjesë e planeve mësimore shkollore.** Ekspertët e sigurisë e citojnë arsimin si mjetin më efikas për mbrojtje të fëmijëve nga rreziqet në linjë, edhe pse tani për tani relativisht pak sisteme shkollore kanë futur sigurinë në internet si pjesë detyimore të planit mësimor. Microsoft beson se të gjithë nxënësit do të duhej të mësojnë se si t'u shmangen rreziqeve në linjë, të mbrojnë kompjuterët e tyre familjarë dhe të sillen me etikë në internet. Arsimi për siguri në internet është gjithashtu fushë në të cilën qeveritë mund të krijojnë partneritete me kompanitë për teknologji interneti, organizata për siguri në linjë dhe të tjerë që mund të ndihmojnë në plotësimin e kësaj nevoje.
- **Mandatimi i studimeve dhe financimi i hulumtimeve për të përparuar sigurinë në internet.** Me përhapjen dhe evoluimin e shpejtë të internet, përhapen dhe rreziqet e sigurisë në linjë dhe metodat e shënjestrimit të fëmijëve të cenueshëm. Për të mbrojtur më mirë fëmijët në linjë, prindërit, arsimtarët, vendim marrësit dhe udhëheqësit e biznesit kanë nevojë për informata aktuale dhe të mprehta për të ndryshuar pejsazhin e internetit. Financimi qeveritar është thelbësor për hulumtimet akademike dhe industriale për rreziqet nga interneti në shfaqje e sipër, tendencat në sjelljen në linjë të fëmijëve; mënyra të reja të përparimit të sigurisë, fshehtësisë dhe sigurimit; dhe fusha tjera të studimit.
- **Përkrahja e ngjarjeve të bashkësisë që promovojnë sigurinë në internet.** Qeveritë mund të ndihmojnë në arsimimin e fëmijëve dhe të rriturve për një përdorim shumë më të sigurtë dhe të përgjegjshëm të internetit duke ndihmuar ngjarje lokale që i paraqesin këto tema në format joshës. Shembujt përfshijnë kuvendet shkollore, seminarët e bashkësisë, forume të udhëheqësve të biznesit, samiteve rinore, panairëve të bashkësisë dhe diskutime në tryeza të rrumbullakta. Vetëdijësimi dhe kyqja që rezulton nga këto ngjarje mund të ndihmojë pjesëmarrësit të ndajnë atë që kanë mësuar me të tjerë.

Përfundim

Nuk ka vetëm një zgjidhje - në teknologji, arsim, legjislacion apo politikë qeveritare - që mund tu përgjigjet sfidave komplekse të sigurisë në linjë të fëmijëve. Përpjekjet aktuale dhe bashkëpunimi në të gjitha këto fusha – krahas pjesëmarrjes së fuqishme prindërore, mbikqyrjes dhe udhëzimit – janë të nevojshme për të ndihmuar të sigurohemi se interneti ngelet një mjedis pozitiv dhe i shëndoshë për fëmijët dhe adoleshentët.

Microsoft ka kohë që është i përkushtuar në ndihmë të mbrojtjes së fëmijëve në linjë. Kemi qasje gjithëpërfshirëse për sigurinë në linjë që përfshin dhe zhvillimin e teknologjive të sigurisë familjare, udhëzimit

dhe arsimimit për familjet dhe fëmijët, si dhe partneritete me industrinë, organizata joqeveritare dhe forca të fuqizimit të ligjit për të ndihmuar luftën e krimit në linjë.

Siguria në linjë e fëmijëve radhitet drejtë për drejtë me përkushtimet e përgjithshme të Microsoft për promovimin e besimit më të madh dhe ndërtimit të prodhimeve dhe shërbimeve që përparojnë sigurinë e konsumatorëve. Microsoft do të vazhdojë investimin në programe, teknologji dhe partneritete që përparojnë qëllimet e një përdorimi më të sigurtë të kompjuterëve për fëmijët dhe familjet.

SShënime

¹ Robin M. Kowalski and Susan P. Limber, “**Electronic Bullying Among Middle School Students.**” *Journal of Adolescent Health*, December 2007 (Vol. 41, Issue 6, Pages S22-S30).

² Cox Communications Analiza për Internet Sigurinë e Adolehentëve, Vala II – në Partneritet me Qendrën Kombëtare për Fëmijë të Zhdukur dhe Eksploatuar (QKFZhE) dhe John Walsh, Mars 2007.

http://www.cox.com/TakeCharge/includes/docs/survey_results_2007.ppt. Profili shoqëror i përdoruesit është faqja personale e përdoruesit në një rrjet shoqërimi. Profilët shpesh kanë dhe informata mbi personin, fotografi, video, bllog personal dhe informata kontakti.

³ “A European Research Project: The Appropriation of New Media by Youth.” Mediapro, 2006.

<http://www.mediapro.org/publications/finalreport.pdf>.

⁴ “Norton Online Living Report. Symantec, 2008.

http://www.symantec.com/content/en/us/home_homeoffice/media/pdf/nolr/080214_aus_norton_online_living_report_nolr-final.pdf.

⁵ Ibid.

⁶ Systems for rating age-appropriateness of video and game content vary by country or by region. They include the Entertainment Software Rating Board (www.esrb.org) in the United States and Canada, the British Board of Film Classification (www.bbfc.co.uk) in the UK, the Game Rating Board (<http://grb.or.kr>) in Korea, Unterhaltungssoftware Selbstkontrolle (www.usk.de) in Germany, and Pan-European Game Information (www.pegi.info) in much of Europe.